

**Kaloni pesë minuta për t'u njohur me të drejtat tuaja si konsumator i energjisë elektrike!**

#### **I nderuar konsumator,**

Duke filluar nga data 1 janar 2015, ju si konsumator shtëpiak do të keni të drejtë të zgjedhni furnizuesin tuaj të energjisë elektrike. Kjo do të thotë se do të keni mundësi të vendosni se nga cili furnizues do ta merrni energjinë elektrike, si dhe të zgjedhni ofertën që ju përshtatet më së miri.

Me fjalë të thjeshta, kjo quhet “hapje e tregut të energjisë”.

Sipas ligjit të energjisë elektrike, nga data 1 janar 2015 të gjithë konsumatorët janë konsumator të kualifikuar dhe se kanë të drejtën e zgjedhjes së furnizuesit. Aktualisht në Republikën e Kosovës nuk ka furnizues tjerë, përveç furnizuesit publik, por në të ardhmën mund të pritet që të ketë edhe furnizues tjerë të licencuar.

#### **Disa fjalë për teknikën**

Energjia elektrike që ju përdorni prodhohet në impiante specifike. Për të ardhur në shtëpinë tuaj, duhet të kalojë nëpërmjet rrjetit të energjisë elektrike. Shtëpia juaj është e lidhur me rrjetin e shpërndarjes, i cili menaxhohet nga kompania e cila vepron në zonën ku jetoni. Kjo kompani është përgjegjëse për dërgimin fizik të energjisë elektrike në shtëpinë tuaj.

#### **Disa fjalë për ekonominë**

Aktualisht, ju si konsumator shtëpiak, keni një kontratë për furnizimin me energji elektrike me një kompani e cila e ka ofruar gjithmonë këtë shërbim në zonën tuaj. Në disa raste, është e njëjta kompani (kompania shpërndarëse) me të cilën është e kyçur shtëpia juaj. Kjo kompani është përgjegjëse për blerjen (dhe/ose prodhimin) e energjisë elektrike me qëllim që t'ju shesë juve.

Në esencë, kjo është kompania të cilës poashtu i paguani për energjinë elektrike.

#### **Çfarë do të ndryshojë? – EKONOMIA, jo TEKNIKA**

**NËSE JU E PËRDORNI TË DREJTËN TUAJ**, ju e ndryshoni subjektin të cilin e paguani për energjinë.

Me hapjen e tregut, secilit konsumatori i jepet mundësia të kalojë në një furnizues tjetër. Kjo do të thotë se furnizuesi juaj aktual nuk do të jetë zgjedhja juaj e vetme dhe ju nuk detyroheni që të merrni shërbime nga furnizuesi juaj aktual.

**POR** – Lidhja fizike nuk ndryshon!



#### **Cilat janë arsyet për ta ndërruar furnizuesin? – SEPSE JU JENI AI QË PAGUAN**

Për kompaninë ju nuk jeni thjesht konsumator, por edhe klient. Si klient keni të drejtë qasjeje në politikën e çmimeve të furnizuesit tuaj, nivelin e shërbimit për konsumatorin, mundësit e pagesave e kështu me radhë. Në rast se nuk jeni të kënaqur me shërbimin aktual dhe/ose keni gjetur një çmim më të mirë nga një furnizues tjetër, ju mund ta përdorni të drejtën tuaj për ta ndryshuar furnizuesin.

### **Si bëhet ndryshimi**

Furnizuesit me energji elektrike propozojnë një shumëllojshmëri të ofertave. Ju shqyrtoni ofertat e ndryshme të furnizuesve të ndryshëm dhe zgjedhni atë që mund të sigurojë ofertën më të mirë, në kuptimin e çmimit, performancës, e kështu me radhë.

### **Cilat janë përfitimet? – KJO VARET NGA ZGJEDHJA JUAJ**

Nëse mendoni të ndryshoni furnizuesin, kjo do të thotë se nuk jeni i kënaqur me furnizuesin aktual ose se një tjetër furnizues paraqet një ofertë më të mirë.

Sigurisht, një prej kritereve kyçe është çmimi për njësi të energjisë. Mund të kurseni para nëse çmimi i furnizuesit të ri është më i ulët sesa çmimi që ju paguani aktualisht. Nëse nuk gjeni oferta më të lira në treg, mund të vazhdoni me furnizuesin aktual.

Falë hapjes së tregut, ju mund ta ndryshoni përsëri furnizuesin, në rast se nuk jeni të kënaqur me furnizuesin e ri.

### **Ku të gjindet furnizuesi i ri?**

Me hapjen e tregut, furnizuesit e rinj do të fillojnë të ofrojnë shërbime për konsumatorët shtëpiak dhe të promovojnë (reklamojnë) ofertat e tyre. Është në dorën tuaj të zgjedhni ofertën më të mirë dhe të përdorni mundësit tuaja si konsumator.



### **A mund të mos ndryshoj asgjë? – PO**

Ju nuk jeni i detyruar ta ndryshoni furnizuesin nëse nuk dëshironi. Përveç kësaj, furnizuesi aktual është i obliguar t'ju furnizojë me energji elektrike me çmime të cilat tashmë rregullohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

### **Si mbrohen të drejtat e mia në tregun e energjisë? – JU JENI TË MBROJTUR NËSE JENI TË VETËDIJSHËM PËR TË DREJTAT TUAJA**

Autoriteti rregullator i energjisë i Republikës së Kosovës është partneri juaj në çështjet që lidhen me tregun e energjisë. Si organ i pavarur, ZRRE nxjerr rregulla për garantimin e konkurrencës së ndershme dhe informata për konsumatorët lidhur me të drejtat e tyre, legjislacionin aktual, kontratën e re dhe procedurat e zgjidhjes së ankesave dhe kontesteve. Zyra e Rregullatorit për Energji është në dispozicionin tuaj për çdo pyetje dhe/ose ankesë në: [ankesa.DMK@ero-ks.org](mailto:ankesa.DMK@ero-ks.org)

Kjo broshurë është një mjet njoftimi, e cila synon t'ju japë njoftimin (informatën) e parë lidhur me atë që do të ndodhë së shpejti në tregjet e energjisë. Aktualisht, autoritetet publike janë duke punuar për legjislacionin gjithëpërfshirës dhe rregullat rregullatore për tregjet e energjisë.

### **JENI TË INTERESUAR për MË SHUMË HOLLËSI?**

Për të gjetur informata për hapjen e tregut të energjisë, ju mund të kontaktoni 038-247-615.

ose mund të vizitoni faqen e internetit: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

Kjo broshurë është mbështetur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë